



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELVIRA G. ALIBALI  
ADRESA NR.7, BLV"GJERGJ  
FISHTA", KATI I PARE, NR. 6/1  
TEL: 682035257

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1606


Nr. koleksioni: 503

Tirane më 19/07/2022

**Ligjet referuese:**

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

"Akti noterial përbëhet nga 3 fletë"



A2022052460053792265



A2022052460053792265

## KONTRATË DHURIMI

### KUOTASH KAPITALI TE SHOQËRISË "Deumsoft"

Sot, më datë 19/07/2022, (dymije e njezet e dy), dite e marte, para meje Notere ELVIRA G. ALIBALI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, BLV"GJERGJ FISHTA", KATI I PARE, NR. 6/1, u paraqiten personalisht:

**DHURUES:** Paul Hila, atësia Marçel, amësia Ardiana, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në TIRANË, me adresë Sali Butka; Nd. 17; H. 21; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 08/11/1992, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me dokument identifikimi nr. personal J21108046R, *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")*.

**PRANUES I DHURIMIT:** Gjergj Bardhi, atësia Ndrek, shtetas Shqiptar, lindur në Shkoder dhe banues në Shkoder, me adresë Shkoder, Lagjia 'Tom Kola', Skenderbeg, Rruga:"Daniel Matlia", lindur më 13/03/1972, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me dokument identifikimi nr. personal H20313101F, *(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")*.

#### Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

#### TË DHËNA PARAPRAKE

Pala dhuruese e kuotave/pjesëve, është ortak i vetëm i Shoqërisë «Deumsoft» Sh.p.k, që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, e regjistruar në Q.K.B me Nr. NIPTI M11503024A, me adresë kyesore në Rruga: 'Sali Butka'; Nd. 17; H. 21; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, me ortak të vetëm Paul Hila, Vlera e kapitali në para 100,00, Numri i pjesëve 1,00, pjesëmarrja në përqindje (%) 100, 00 .

Dhuruesi dhe pranuesi i dhurimit kanë rënë dakord që të lidhin këtë kontratë dhurimi me kushtin e mëposhtëm: Kuotat që dhurohen të transferohet me vlerën e tyre nominale siç është përcaktuar me poshtë në këtë kontratë dhurimi dhe dhurimi bëhet vetëm në favor të pranuesit të dhurimit Gjergj Bardhi, duke u konsideruar pasuri vetjake e tij.

**ATËHERE,** palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

#### NENI 1

#### OBJEKTI I KONTRATËS

Me nënshkrimin e kësaj kontrate e sipas kushteve vijuese, Dhuruesi Paul Hila i dhuron shtetasit-pranuesit të dhurimit Gjergj Bardhi dhe ky e fundit pranon dhurimin për 1,00 (një) kuotë/pjesë të



saj të barazvlefshme me 100,00 (njëqindpërqind)% të kapitalit të shoqërisë, që ai zotëron në këtë shoqëri me vlerë nominale në para prej 100,00 (njëqind) Lekë

## **NENI 2**

### **TRANSFERIMI I PRONËSISË MBI KUOTAT**

Pronësia mbi kuotot transferohet menjëherë nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me nënshkrimin e kontratës së dhurimit, ortaku i vetem i shoqërisë Paul Hila, do të heqë dorë përfundimisht nga çdo e drejtë e ligjshme pasurore dhe cdo detyrim që kishte tashmë në shoqëri, nga të gjithë aktivet dhe pasivet e Shoqërisë, duke u shkëputur njëherë dhe përgjithmonë nga kuotat/pjeset që ai zotëronte në Shoqëri

Të gjithë të drejtat dhe detyrimet që ai mbante në shoqëri, do t'i kalojë ortakut të vetem të ri të shoqërisë **Gjergj Bardhi**.

Dhuruesi deklaron dhe garanton se kuotat janë të lira nga çdo peng, privilegj, barrë apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve, pa kufizime për tjetërsimin e tyre, kuotat nuk janë objekt i ndonjë mosmarrveshje, dhe nuk janë të pezulluara. Për këtë qëllim bazuar në dispozitat ligjore **dhuruesi është pajisur me dt. 18/07/2022 me Konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, që provon këtë gjë.**

## **NENI 3**

### **TË NDRYSHME**

Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit se kuotat/pjeset që transferon nëpërmjet kësaj kontrate janë të lira nga çdo barrë.

Dhuruesi deklaron dhe garanton se Shoqëria nuk është në proces falimentimi, likuidimi të vullnetshëm ose jo apo në ndonjë proces të ngjashëm.

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Pranuesi i Dhurimit **Gjergj Bardhi**, bëhet pronar i vetem dhe ekskluzive e 1,00 pjesëve/kuotova, të barazvlefshme me 100,00 (njëqindpërqind)% të kapitalit të Shoqërisë "Deumsoft" sh.p.k me vlerë nominale 100,00 (njëqind) lekë.

Pranuesi i dhurimit njekohesisht me këtë akt pranon aktin e themelimit të shoqërisë, statutin e saj, vendimet e marra deri në datën e nënshkrimit të këtij akti si të vlefshme, të pakontestuar, e në fuqi.

## **NENI 4**

### **BAZA LIGJORE**

Kjo kontratë, do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (i ndryshuar) Pjesën IV të tij, për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, statuti i shoqërisë si dhe çdo dispozite tjetër ligjore të cilës i bëhet referim në këtë kontratë.

Neni 761 e vijues të Kodit Civil

Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"



Neni 5

### Dispozitat Përfundimtare

Kontrata e kalimit të kuotave, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje

Noteres. Kontrata hartohet në dy fletë, dhe në 4 kopje të barazvlefshme, një kopje e kontratës i jepet palës dhuruese, një kopje pranueses së dhurimit, një kopje për depozitim në Q.K.B së bashku me Vendimin e Asamblesë.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Bashkëlidhr gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

### PALET KONTRAKTUESE

#### DHURUES

Paul Hila

#### PRANUES DHURIMI

Gjergj Bardhi

NOTERE

ELVIRA G. ALIBALI



**VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKUT TË VETËM  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Deumsoft" SH.P.K.**


Sot me datë 19/07/2022, unë **Paul Hila** atësia Marçel, datëlindja 08/11/1992, lindur në Shkodër dhe banues në adresen Rruga: 'Sali Butka'; Nd. 17; H. 21; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, me dokument identifikimi me Nr.personal J21108046R, Ortak i Vetëm i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**Deumsoft**" Sh.p.k, e regjistruar në Q.K.B me Nr. NIPTI M11503024A, me adresë kyesore në Tiranë, Rruga: "Shefqet Musaraj 26", Tirane, Shqiperi, Kodi postar 1001, pasi mora në shqyrtim rendin e ditës:

**VENDOSA:**

- Miratimin për transferimin e pronësisë nëpërmjet dhurimit të 1,00 kuote/pjesë që unë zotëroj në këtë shoqëri, e barabartë me 100,00 (njëqind përqind) % të kapitalit të shoqërisë, me vlerë nominale në para prej 100,00 (njëqind) Lekë shtetasit Gjergj Bardhi.
- Miratimin për nënshkrimin e kontratës e dhurimit mes ortakut të vetem te shoqërisë "**Deumsoft**" shpk, Paul Hila dhe shtetasit Gjergj Bardhi.
- Me nënshkrimin e kontratës së dhurimit unë ortaku i vetëm i shoqërisë Paul Hila do të heq dorë përfundimisht nga cdo e drejtë e ligjshme pasurore dhe nga cdo detyrim që kisha në shoqëri, nga të gjithë aktivet dhe pasivet e Shoqërisë, duke u shkëputur njëherë dhe përgjithmonë nga pjesët/kuotat që unë zotëroj.
- Shoqëria "**Deumsoft**" Shpk, autorizon Gjergj Bardhi, datëlindja 13/03/1972, lindur në Shkodër dhe banuese në Shkoder, Lagjja : « Tom Kola », Skenderbeg, Rruga : « Daniel Matlia », ID Nr.personal H20313101F, të depozitojë këtë Vendim Asambleje dhe Kontratën e dhurimit të kuotave në Q.K.B për të pasqyruar ndryshimet e duhura.

**Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar  
"Deumsoft" SH.P.K.**

Paul Hila







## Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,  
"Selvia", Kati V  
TIRANË, SHQIPERË  
TEL/FAX :355 4 2420005  
TEL:355 4 2420006  
Email: rbs@roen-al.com

### REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20220718121029212  
Data e Rezultatit të Kerkimit: 18.07.2022  
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 12:10:29PM  
Lloji i Kerkimit: D-400-103-1480  
Numri i Dokumentit:  
Referenca e Perdoriesit:

#### LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

PAUL MARCEL-HILA  
DEUMSOFT SH.P.K.



Samela  
Elzeqaj

